



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 462 Prot.

Tiranë, më 06/ 09/ 2013

Lënda : Dërgohet rekomandim për marrjen e masave urgjente për miratimin e udhëzimit të përbashkët midis Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, për vitin shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor parauniversitar.

Drejtuar : Z. Myqerem TAJAJ
MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

TIRANË

Z. Ridvan BODE
MINISTËR I FINANCAVE

TIRANË

Të nderuar zotërinj Ministra!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka miratuar udhëzimin nr. 46, datë 23.08.2013 “ Për vitin shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor parauniversitar”, por nuk rezulton të jetë miratuar akoma udhëzimi i përbashkët me Ministrin e Financave, i cili do të hapte rrugën për miratimin e fondit dhe bërjen efektive të masave të parashikuara për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore për fëmijët dhe nxënësit romë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit dhe statusin e të verbërit, fëmijët e emigrantëve dhe pakicave kombëtare, fëmijët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, apo kategori të tjera të përfshira.

Nga praktika e viteve të mëparshme, por duke mbajtur në vëmendje edhe afatet kohore të vendosura në këtë udhëzim për fillimin e vitit shkollor, procedurat për miratimin e këtij udhëzimi të përbashkët janë me vonesë. Vonesa në miratimin e këtij akti nënligjor mund të sjellë pasoja negative për kategoritë e nxënësve që përfitojnë kompensimin e çmimit të teksteve shkollore.

Për përmirësimin e situatës arsimore të minoritetit rom, në Planin Kombëtar të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes së Rome, 2010-2015, masa e parashikuar për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë, është një masë që e shtrin veprimin e saj deri në vitin 2015.

Zbatimi i detyrimeve ligjore për marrjen e masave që synojnë përsheptimin e vendosjes reale të barazisë janë të domosdoshme për të luftuar dhe eliminuar diskriminimin në të drejtën për arsim të personave, dhe dështimi për të zbatuar me efektivitet këto masa mund të çojë në diskriminimin e grupeve të caktuara, të cilët gjenden në rrethana dhe kushte të ndryshme nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Nisur nga situata e krijuar si dhe bazuar në kompetencat që ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i jep institucionit të Komisionerit për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

REKOMANDON

Marrjen e masave urgjente nga ana e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave për të miratuar udhëzimin e përbashkët, që do të lejonte çeljen e fondit për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore për kategoritë vulnerabel të nxënësve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,



Konc. J. Januzaj, specialeste



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al